

## **MARREVESHJE**

Në Tiranë, sot më datë 07/12/2023, në selinë e shoqërisë "GREEN LINE" shpk, në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Ligjit Nr 9723, datë 03.05.2007, për "Qendrën Kombëtare të Biznesit" i ndryshuar,

Pas shqyrtimit të veprimtarisë ekonomike, financiare, diskutimeve dhe konsultimeve me ekspertë, si dhe nevojës për t'u zhvilluar në tregun ekonomiko-financiar, në cilesinë e Administratorit të shoqërive që do të përfshihen në procedurën e përthithjes si dhe në referencë të Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008, për "Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" i ndryshuar , Ligjit Nr 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit "pasi aksionerët kanë vlerësuar si të përshtatshme dhe me interes përthithjen e shoqërisë "Green Taxi "shpk nga shoqëria "Green Line" shpk për ecurinë më të mirë të shoqërisë në të ardhmen, për të siguruar vijimësi , qëndrueshmëri dhe siguri të veprimtarisë ekonomike- financiare, **hartojmë këtë projekt marrëveshje për bashkimin nëpërmjet përthithjes së shoqërive "Green Line" shpk dhe shoqërisë "Green Taxi" shpk.**

### **PALET:**

**1- SHOQERIA « GREEN LINE » SHPK,** e pajisur me NIPT L91924024I, me seli në Rr "Bardhyl" pallati Nr 109 Perxholla Tiranë", me ortak te vetëm Nadir Çausholli dhe përfaqësuar në këtë akt marrveshje nga Administratori Eluar Abdyl, i biri i Agronit, i dtl 12.12.1998, lindur ne Lezhë, dhe banues në Tiranë, i pajisur me kartë identiteti Nr.181212068G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**2- SHOQERIA "GREEN TAXI " shpk,** e pajisur me NIPT L71719034F, me seli në Rr "Themistokli Germenji" Pallati "Frashëri" Tiranë , me ortak të vetëm Nadir Çausholli dhe përfaqësuar në këtë akt marrveshje nga Administratori Endrit Masha, i biri i Ismailit , i dtl 06.04.1982, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i pajisur me kartë identiteti Nr.120406061K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**BAZA LIGJORE:** Neni 215 e në vijim e Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare", I ndryshuar; Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " I ndryshuar; Vendimin e Asamblesë së Ortakut të vetëm të shoqërisë "GREEN LINE" shpk , datë 04.12.2023. "Për inicim procedure bashkim me përthithje"; Vendimin e Asamblesë së Ortakut të vetëm të shoqërisë "GREEN TAXI " shpk datë 04.12.2023. "Për inicim procedure bashkim me përthithje";



***Te cilet rane dakord ne nenshkrimin e kesaj projektmarreveshjeje, si ne vijim:***

- 1-** Shoqëria "Green Taxi " shpk, e pajisur me NIPT L71719034F dhe seli në Rr "Themistokli Germenji" pallati Frashëri së bashku me Shoqërinë "Green Line" shpk, pajisur me NIPT L91924024I, me seli në Rr "Bardhyl"pallati Nr 109,Perxholla ,Tiranë kanë rënë dakord që Shoqëria "Green Taxi " shpk do të jetë pjesë e shoqërisë "Green Line" shpk, duke u përthithur nga "Green Line " shpk me anë të procedurës së bashkimit me përthithje.
- 2-** Shoqëria "Green Line" shpk zotëron 100 % të kuotave të shoqërisë "Green Taxi" shpk. Nadir Çausholli zotëron 100 % të kuotave të shoqërisë "Green Line " shpk. Shoqëria "Green Line"shpk **e shënuar në vijim si shoqëria përfituese e kontributeve.**
- 3-** Ortakut të vetëm të shoqërisë "Green Taxi " shpk, i cili është subjekti "Green Line " shpk, i lind e drejta e përfitimit të fitimit që nga dita e miratimit të akt marrveshjes ndërmjet dy shoqërive dhe kontabilizimit të veprimeve financiare në shoqërinë përthithëse.
- 4-** Meqënëse shoqëria e përthithur "Green Taxi" zotërohet 100% nga shoqëria përthithëse "Green Line " shpk, atëherë nuk rezulton ndonjë problem i mundshëm ligjor lidhur me të drejtat e zotëruesit të kuotave, si rrjedhojë e faktit të pronësisë 100% nga "Green Line " shpk
- 5-** Për faktin se,Shoqëria e përthithur "Green Taxi " shpk nuk ka të njëjtin administrator si shoqëria përthithëse- "Green Taxi " shpk, **Administratori do të ketë të gjitha të drejtat që Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" I Ndryshuar i njeh , me përjashtim të kompetencës së përfaqësimit dhe kryerjes së veprimeve të ndryshme financiare pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë, kompetence të cilen do ta ketë ortaku I vetëm i shoqërisë "GREEN LINE " shpk, Z. Nadir Çausholli .**
- 6-** Ortakët e vetëm të dy shoqërive që kanë marrë pjesë në procedurën e bashkimit me përthithje, kanë rënë dakord që më dt 04.12.2023 do të nënshkruanin akt marrëveshjen e bashkimit me përthithje, duke përfunduar brenda datës **13.12.2023 të gjitha** procedurat ligjore dhe tatimore të domosdoshme për konkludimin e kësaj faze.
- 7-** Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë së përthithur "Green Taxi"l kalojnë shoqërisë perthithëse "Green Line "shpk.



8- Të gjitha aktivet e pasivet e shoqërisë së përthithur si dhe licenca apo leje te ndryshme në shërbim të aktivitetit I kalojnë shoqërisë përthithëse “Green Line” shpk .

9- Shoqëria “Green Taxi” shpk, si shoqëri e përthithur nga shoqëria “Green Line” në përfundim të këtij procesi do të priset pa likujdim, duke kaluar plotësisht trashëgiminë ekonomike,financiare dhe ligjore te shoqëria përfituese,në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit perfundimtar të operacionit.

10- Bashkimi do të hyjë në fuqi në datën e mbledhjes së fundit të shoqërisë tregtare që do të miratojë operacionin .

### PALET:

**“GREEN TAXI” SHPK  
ADMINISTRATOR**

**ENDRIT MASHA**



**“GREEN LINE SHPK  
ADMINISTRATOR**

**ELUAR ABDYLI**

